3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

- Shtojca 1. Formulari i Ofertës .....
- Shtojca 2. Lista e Çmimeve të Sherbimeve .....
- Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës .....
- Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial.....
- Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike .....
- Shtojca 6. Formulari i shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit .....
- Shtojca 7. Termat e referencës
- Shtojca 8. Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve .....
- Shtojca 9. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....
- Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit .....
- Shtojca 11 - Formulari i Njoftimit të Fituesit .....
- Formulari 12 Formulari i Njoftimit të Fituesit (Pas procesit të ankimit)
- Shtojca 13 : Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër
- Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Pas procesit të ankimit)

---

## Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Shërbimeve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
  - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
    1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
    2. Njoftimin e Kontrates;
    3. Kriteret e Përzgjedhjes;
    4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
    5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
    6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
    7. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
  - (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
  - (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

---

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë _____</b>	

**Shtojca 2.**

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

**LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE**

**Data:** \_\_\_\_\_

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**

\_\_\_\_\_

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE): \_\_\_\_\_

**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Shërbimet në Formularin e grafikut të realizimit për Shërbimet duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për Shërbim. Shërbimet pa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Shërbimi	Përshkrimi i shërbimi	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total për shërbim(3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	<b>Çmimi total (Shërbimet)</b>				_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Çmimi total me TVSH:</b>					
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>					
<b>Nënshkrimi</b>					
<b>Vula</b>					



---

<b>Datë</b> _____	
-------------------	--

---

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

---

#### **Shtojca 4.**

*(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)*

#### **Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### **VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Përfaqësuesi i Ofertuesit**

#### **Nënshkrimi**

#### **Vula**

---

## Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

#### **2. QËLLIMI I PUNËS:**

Qëllimi i detyrës së projektimit është hartimi i projekt- preventivit të zbatimit të objektit

“Ndërtimi i rrjetit të K.U.Z dhe K.U.B në fshatin Verbas, Bashkia Patos”.

Për realizimin e projektit projektuesi duhet të njihet me informacionin egzistues lidhur me të dhënat që kërkon projekti sipas detyrës së projektimit dhe për çdo problem duhet të konsultohet me Sh.a. Ujesjelles Kanalizime Patos. Cilësia e studimit dhe projektimit duhet të jetë e tillë që të arrihen standartet e kërkuara dhe të plotesojë kushtet teknike të projektimit në fuqi.

#### **3. NEVOJA PËR REALIZIMIN :**

Ndërtimi i KUZ **te Fshatit Verbas** bëhet me qëllim disiplinimin e ujrave te zeza te zones si dhe te atyre siperfasore për të plotësuar nevojat për sot dhe për një perspektivë 20-25 vjeçare.

---

#### **4. PËRSHKRIMI I SHKURTËR I GJËNDJES EGZISTUESE:**

Rjeti egzistues i ndertuar ne vitet 80 me jocilesore eshte shume I amortizuar. Zona ku shtrihen tubacionet eshte kryesisht zone fushore e perbere nga ana gjeologjike prej argjile dhe toka bujqesore. Rjeti do te shtrihet ne gjithë blloqet e banimit te fshatit Verbas si dhe do te jepet zgjidhje teknike per trajtimin e ketyre ujrave para derdhjes ne piken e shkarkimit. Klima e kësaj zone është mesdhetare, me dimër të bute dhe të lagësht i cili favorizon burime të shumta ujore. Kjo vendodhje vetëm se i rrit sigurinë këtij projekti. Gjendja ekzistuese ne fshatin Verbas eshte e tille qe nuk ka fare rrjet KUZ. Gjithë blloqet e banimit te shtepive ne zone, disiplinojne ujrat nepermjet gropave septike ose kanaleve siperfaqesore te hapur. Keto kanale shpesh behen burime infeksioni ne zone dhe paraqesin rrezik te larte ndotje mjedisore. Gjithashtu ,percec kesaj, keto ujra, perziere edhe me ujrat siperfaqesore , shkakrohen ne kanale kulluese duke shkaktuar ndotje te shumta.

**-Gjendja aktuale e K.U.Z.,pershkrimi.**(viti ndertimit,gjendja teknike etj).nuk ka rrjet te mbyllur kanalizimesh. Shkarkimet deri me sot jane realizuar me kanale te hapura

**-Popullsia.(numri I banoreve,konsumatoret etj).**Fshati Verbas ka rreth 900 banore. Ambulance me 30 paciente, dhe 6 lokale bar-kafe , 3 dyqane fruta-perime.

**-Shtrirja Gjeografike.(ha-siperfaqja).**Fshati Verbas shtrihet ne Perendim te qytetit te Patosit dhe shtrihet ne pjesen perendimore te aksit rrugor Fier-Berat.

#### **5. TË DHËNAT PËR PROJEKTIM :**

Projektuesi duhet të bëjë studimin e projektit të KUZ te ketij fshati duke I dhene zgjidhje teknike edhe impiantit te trajtimit te ketyre ujrave.

Të bëhet analiza tekniko – financiare e varianteve, preventivin paraprake të varianteve dhe të argumentohet varianti më i leverdisshëm. Në varësi të variantit përfundimtar projektuesi do të hartojë projekt- preventivin e detajuar përfundimtar me gjithë detajet e nevojshme. Vendorsjen si detyrë projektuesit të bëhet studimi gjeologo-inxhinierik i trasese të variantit më të mirë të leverdisshëm , duke hartuar një raport gjeologjik . Hartimin e planit të organizimit, të përcaktojë teknologjinë e hapjes së trasese dhe makineritë e nevojshme duke marë parasysh dhe mundësinë e hapjes së fronteve rezervë për shpejtimin e punimeve. Projektuesi duhet të hartojë përveç projektit të zbatimit edhe preventivin përkatës..

#### **6. HIDROGJELOGJIA**

Projektuesi gjatë hartimit të projektit të zbatimit duhet të ketë parasysh këto të dhëna hidrogjeologjike: terreni ku pretendohet te shtrihet projekti eshte ne nje zone fushore me disnivel shume te vogla te terrenit. Nga pikepamja hidrologjike, zona ne fjale eshte e zhvilluar me rrjet te kanalizimeve te kullimit te ujrave siperfaqesore

---

,te cilat bejne disiplinimin e ketyre ujrave. Duhet te kihet parasysh qe zhvillimi I linjave te KUZ te shmangin keto rryete te kullimit , ose trajtimi I tyre te bhet conform kushteve teknike.

## **7. MBI KUSHTE INXHINIERO-GJEOLOGJIKE**

KUZ e fshatit Verbas do të shërbejë për të plotësuar kerkesen bazike te largimit te ujrave te ndotura .Në bazë të materialit të grumbulluar, ne mund të japim në mënyrë të përmbledhur këtu kushtet inxhiniero- gjeologjike të zonës, ku mund të zgjidhen variantet për kalimin e këtij projekti te KUZ. Këto kushte do të shërbejnë për të mbështetur fazën e projekt idesë. Fazat e mëvonshme të projektimit do të kërkojnë gjithashtu edhe studime të tjera plotësuese, të cilat do të jene më të thelluara e më të plota. Duke pasur parasysh edhe kërkesen e projektit, studimi te perfshije një zonë të gjerë, për të pasqyruar sa me mire kushtet inxhiniero - gjeologjike të saj dhe për të dhënë mundësi zgjidhjes së variantit më të përshtatshëm për kalimin e këtij ujësjellësi. Mbështetur në ndërtimin gjeologo - tektonik të zonës, kushtet inxhiniero - gjeologjike e hidrogjeologjike, si dhe dukuritë fiziko - gjeologjike e karstike, për zgjidhjen e trasese se kalimit të këtij ujësjellësi .

## **8. KËRKESAT QË DUHET TË ZGJIDHË PROJEKTI.**

- 1- Të meret në konsiderate trajtimin e të gjithë sasisë së ujit që gjenerohet nga blloku I banimit.
- 2- Projekti do të hartohet per fshatin Verbas dhe gjithë banesat qe ajo perfaqson .
- 3- Të maret në konsiderate traseja egzistuese.
- 4- Të meret në konsiderate hartimi i projektit për vepren e trajtimit te ujit te ndotur.
- 5- Të bëhet studimi i plotë gjeologo – inxhinierik i aksit të linjes nga pika fundore e projektit deri ne ate te shkarkimit kryesor, dhe për këtë të hartohet raporti gjeologo –inxhinierik duke u plotësuar me çpime dhe kampionet përkatëse për të përcaktuar sa më ekzakt gjelologjinë e formacioneve të tokës .
- 6- Projektuesi të marë në konsideratë anën gjeologjike të trasesë ku do të kalojnë linjat.
- 7- Projektuesi duhet të hartojë projektin e zbatimit të pusetave te mundshme gjate trasese .
- 8- Projektuesi duhet të hartojë projektin e Impiantit te trajtimit te ujit.

---

9- Projektuesi duhet të hartojë projektin e montimit të armaturave si ajruesa , shkarkues etj.

10- Projektuesi të hartojë preventivin përfundimtar të punimeve për çdo nënobjekt duke pasur parasysh edhe çmimet sipas VKM-së në fuqi.

11- Projektuesi duhet të hartojë grafikun e punimeve dhe përcaktimin e kohëzgjatjes e punimeve për këtë vepër.

12- Projektuesi duhet të beje llogaritjet hidraulike te linjave ku te paraqesi elementet hidraulike. per nje ritje natyrale te popullsise 1.25 % per  $N_p = 900$   
**banore te specifikuar si me poshte :**

13- Projektuesi duhet të hartojë profilat gjatesore , terthore , specifikimet teknike per te gjitha zerat e parashikuara ne preventivin e punimeve nga ana e tij.

**10 REALIZIMI I P ROJEKTIT.** Projekt Zbatimi, Projekt per miratimin e lejes se ndertimit e preventivat se bashku me grafikun e punimeve.

Të kryhet hartimi i Projekt-Zbatimit preventivat se bashku me grafikun e punimeve të objektit:

**" NDERTIMI I RRJETIT TE KUZ NE FSHATIN VERBAS, BASHKIA PATOS "**

i cili duhet te përmbajë:

- 1- Raportin teknik
- 2- Koreografinë e zonës në shkallë 1 : 10.000 - 1 : 25.000
- 3- Hartimi i relievit topografik të zonës ku do të ndërhyhet (kordinata lokale, kuota absolute)
- 4- Planimetrine e zbatimit të plotë të traseve te linjave sipas fshatrave.
- 5- Profilin gjatësor dhe tërthor të të gjithë linjave të skemës;
- 6- Profilat tërthore tip;
- 7- Seksionet e ndyshme të VEPRES SE TRAJTIMIT
- 8- Makinerite dhe paisjet e nevojshme per zbatimin e punimeve
- 9- Hollësitë ndërtimore ,detajet teknike , betonimi , armimi dhe mbeshteset e tubacionit
- 10- Specifikimet teknike për zërat e punimeve që do të kryhen;
- 11- Planin e organizimit të punimeve dhe grafikun e kohëzgjatjes së tyre.
- 12- Marrjen e masave të sigurimit teknik si të punëtoreve ashtu edhe të publikut;
- 13- Raportin e vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM).

- 
- 14- Raportin gjeologo – inxhinierik.
  - 16- Preventivi dhe grafiku i punimeve

## **11 .RAPORTIMI**

I gjithë dokumentacioni do të paraqitet në 3 (tre) kopje orgjinale, dhe ne 3(tre) CD. Llogaritjet, specififikimet teknike dhe preventivi. Relacioni teknik qe shoqeron projektin duhet te permbaje:

- a. Llogaritjet statike të strukturave .
- b. Llogaritjet hidraulike per linjat e tubacioneve, veprën e rrjetit te KUZ ;
- c. Llogaritjet hidraulike
- d. Preventivin e plotë i veprës; Preventivi i objektit të hartohet duke u mbështetur në çmimet manualit në fuqi.
- e. Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM)
- f. Raportin gjeologo – inxhinierik.

## **12. STANDARTET:**

### ***Standarte në projektim.***

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standartet për projektimin që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standarteve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i standarteve dhe normave përkatëse. Projektuesi duhet të rekomandojë dhe prezantimin e standarteve të reja, për përafrimin me normat e BE-së, si edhe të praktikave me të mira ndërkombëtare në projektin dhe zbatim. Rekomandimet duhet të përmbajnë elemente të realizueshmërisë me praktikën shqipëtare dhe limitimet për financimin e veprës. ***Standarte në paraqitjen e dokumentacionit teknik.***

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, projektuesi të përdorë programet e kërkuara kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, më të avancuara të fushës. Në hartimin, paraqitjen dhe miratimin e dokumentacionit teknik të projektit të kihet parasysh dhe të respektohen të gjitha kërkesat dokumentare dhe të paraqitjes që parashikon Ligji “Për Planifikimin e Territorit”, Rregullorja e Urbanistikës dhe Legjislacioni në fuqi. Me anën e këtij raporti teknik të sqarohen investigimet e bëra nga projektuesi për gjendjen egzistuese, kushtet teknike dhe kriteret e projektimit llogaritjet përkatëse për mënyrën e furnizimit me ujë. Gjithashtu të jepen përshkrime për fazat e ndërhyrjes dhe rehabilitimit të sistemit, ,specifikimet teknike për materialet si dhe proceset e punimeve që do të kryhen, vizatimet e nënobjekteve, që do të ndërtohen (planimetri, profila, prerje, hollësi ndërtimore ,detaje teknike etj), si dhe volumet kryesore



---

të punimeve dhe materialeve ,makinerive e pajisjeve që duhen për kryerjen e kësaj ndërhyrjeje për ndërtimin e këtij ujësjellësi dhe për zgjidhjen përfundimisht të problemit të furnizimit me ujë për sot dhe perspektive.

## Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

### FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

#### Shërbimet që kërkohen që kërkohen:

Hartimi i projekt preventivit per objektin: “Ndërtimi i rrjetit të K.U.Z dhe K.U.B në fshatin Verbas, Bashkia Patos”.

Projekt copë 1

Shënim:

I gjithë dokumentacioni do të paraqitet në 3 (tre) kopje orgjinale, dhe ne 3(tre) CD. Llogaritjet, specifikimet teknike dhe preventivi. Relacioni teknik qe shoqeron projektin duhet te permbaje:

- a. Llogaritjet statike të strukturave .
- b. Llogaritjet hidraulike per linjat e tubacioneve, veprën e rrjetit te KUZ ;
- c. Llogaritjet hidraulike
- d. Preventivin e plotë i veprës; Preventivi i objektit të hartohet duke u mbështetur në çmimet manualit në fuqi.
- e. Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM)
- f. Raportin gjeologo – inxhinierik.

Sipas **VENDIMIT Nr. 354, datë 11.5.2016 PËR MIRATIMIN E MANUALIT TË TARIFAVE PËR SHËRBIME NË PLANIFIKIM TERRITORI, PROJEKTIM, MBIKËQYRJE DHE KOLAUDIM**”seksioni IV neni 44 ,cdo oferte ekonomike qe rezulton jashte kufirit minimal dhe maksimal të vlerës do të skualifikohet.

**Afatet e ekzekutimit:**

**30 (tridhjetë) ditë nga nënshkrimi i kontratës**

Shërbimet	Përshkrimi	Shuma	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit

---

## Shtojca 7

( Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

### TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Qëllimi i detyrës së projektimit është hartimi i projekt- preventivit të zbatimit të objektit

“Ndërtimi i rrjetit të K.U.Z dhe K.U.B në fshatin Verbas, Bashkia Patos”.

Për realizimin e projektit projektuesi duhet të njihet me informacionin egzistues lidhur me të dhënat që kërkon projekti sipas detyrës së projektimit dhe për çdo problem duhet të konsultohet me Sh.a. Ujesjelles Kanalizime Patos. Cilësia e studimit dhe projektimit duhet të jetë e tillë që të arrihen standartet e kërkuara dhe të plotësojë kushtet teknike të projektimit në fuqi.

Ndërtimi i KUZ **te fshatit Verbas** bëhet me qëllim disiplinimin e ujrave te zeza te zones si dhe te atyre siperfasore për të plotësuar nevojat për sot dhe për një perspektivë 20-25 vjeçare.

Detyrat:

Projekt Zbatimi, Projekt per miratimin e lejes se ndertimit e preventivat se bashku me grafikun e punimeve.

Të kryhet hartimi i Projekt-Zbatimit preventivat se bashku me grafikun e punimeve të objektit: “Ndërtimi i rrjetit të K.U.Z dhe K.U.B në fshatin Verbas, Bashkia Patos”.i cili duhet te përmbajë:

- 1- Raportin teknik
- 2- Koreografinë e zonës në shkallë 1 : 10.000 - 1 : 25.000
- 3- Hartimi i relievit topografik të zonës ku do të ndërhyhet (kordinata lokale, kuota absolute)
- 4- Planimetrine e zbatimit të plotë të traseve te linjave sipas fshatrave.
- 5- Profilin gjatësor dhe tërthor të të gjithë linjave të skemës;
- 6- Profilat tërthore tip;
- 7- Seksionet e ndyshme të VEPRES SE TRAJTIMIT
- 8- Makinerite dhe paisjet e nevojshme per zbatimin e punimeve

---

9- Hollësitë ndërtimore ,detajet teknike , betonimi , armimi dhe mbeshteset e tubacionit

10- Specifikimet teknike për zërat e punimeve që do të kryhen;

11- Planin e organizimit të punimeve dhe grafikun e kohëzgjatjes së tyre.

12- Marrjen e masave të sigurimit teknik si të punëtoreve ashtu edhe të publikut;

13- Raportin e vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM).

14- Raportin gjeologo – inxhinierik.

16- Preventivi dhe grafiku i punimeve

### **RAPORTIMI**

I gjithë dokumentacioni do të paraqitet në 3 (tre) kopje orgjinale, dhe ne 3(tre) CD. Llogaritjet, specifikimet teknike dhe preventivi. Relacioni teknik që shoqeron projektin duhet te permbaje:

- a. Llogaritjet statike të strukturave .
- b. Llogaritjet hidraulike per linjat e tubacioneve, veprën e rrjetit te KUZ ;
- c. Llogaritjet hidraulike.
- d. Preventivin e plotë i veprës; Preventivi i objektit të hartohet duke u mbështetur në çmimet manualit në fuqi.
- e. Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM)
- f. Raportin gjeologo – inxhinierik.

Shpërndarja:

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve:

Në ambientet e SH.A. UJËSJELLËS KANALIZIME PATOS

I gjithë dokumentacioni do të paraqitet në 3 (tre) kopje orgjinale, dhe ne 3(tre) CD. Llogaritjet, specifikimet teknike dhe preventivi. Relacioni teknik që shoqeron projektin duhet te permbaje:

- a. Llogaritjet statike të strukturave .
- b. Llogaritjet hidraulike per linjat e tubacioneve, veprën e rrjetit te KUZ ;
- c. Llogaritjet hidraulike
- d. Preventivin e plotë i veprës; Preventivi i objektit të hartohet duke u mbështetur në çmimet manualit në fuqi.
- e. Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM)
- f. Raportin gjeologo – inxhinierik.

---

## Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

---

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

---

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2018, 2019 2020, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **799,680** (shtatëqind e nentëdhjetë e nente mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë) lek.

---

#### **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate (*apo shumatores së fondit limit të loteve, nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofertohet për më shumë se një lot*).

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përbushjen me sukses të

---

kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2. Licence per projektim, ne pikat si me poshte:

**-Kategoria 3. Pika a - Projektimi I objekteve Civile**

*Nenkupton punime qe kane te bejne me punimet parapergatitore, bazamenteve te betonit apo nenshtresave te ndryshme me natyre civile.*

**-Kategoria 5 . Pika b – projektimi i kolektoreve shkarkimit**

*Nenkupton perfshirjen e punimeve te ndertimit te pusetave te kontrollit si dhe elementeve te tjera te degezimeve*

**- Kategoria 5. Pika C – Projektimi i kanalizimeve urbane dhe rurale**

*Nen kupton gjithë kategorine e kanalizimeve , te hapjes se kanaleve dhe shtrimit te linjave te tubacioneve sebashku me elementet lidhes te tyre*

**-Kategoria 5. Pika e – Projektim Vepra te trajtimit te ujit**

*Nenkupton veprat e artit qe do te bejne trajtimin primar te ujrave te zeza qe do te grumbullohen*

**-Kategoria 6: Pika a – Projektim rurge rural e interurbane dytesore**

**Pika b- Projektim rurge urbane kryesore**

*Nenkupton procese te riparimit dhe te rikthimit ne gjendjen e mepareshme te rrugeve te brendeshme dhe degezimeve qe do te nderhyet per efekt te kanalizimeve*

**Kategoria 8: Pika a – rilevime topografike**

*Nen kupton punimet e topografimit te rrejetit dhe gjithë terrenit ku do te behet shtrirja e KUZ.*

**Kategoria 14: Projektim te impianteve t trajtimit te ujrave te zeza**

*Nenkupton gjithë impiantin kryesor te trajtimit te ujrave te zeza dhe pastrimin primar te tyre.*

2.3.3.Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, **drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- |  |         |
|--|---------|
| a. Inxhinier ndertimi                      | 1 (nje) |
| b. Inxhinier hidroteknik                   | 1 (nje) |
| c. Inxhinier topograf                      | 1 (nje) |
| d. Inxhinier mjedisi (Profili trajtim uji) | 1 (nje) |

---

Per kete duhet te paraqes Diplome, CV, kontrate pune te vlefshme, dhe te figuroj ne listpagesen e shoqerise nga muaji Tetor 2021 e ne vazhdim.

*Shënim: Ky dokumentacion do të paraqitet nga operatori ekonomik fitues para Lidhjes së kontratës ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK, pasi kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.*

2.3.4. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 4 (katër) persona**.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Dokumentat për të vërtetuar këtë kriter janë:

- a) *Vertetim te leshuar nga Dega e Tatimeve te Rrethit ose nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqerore te rrethit perkates ose me vule elektronike .*
- b) *Listepagesat per periudhen e mesiperme (E-sig 25)*

*Shënim: Ky dokumentacion do të paraqitet nga operatori ekonomik fitues para Lidhjes së kontratës ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK, pasi kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.*

2.3.5: Sipas **VENDIMIT Nr. 354, datë 11.5.2016 PËR MIRATIMIN E MANUALIT TË TARIFAVE PËR SHËRBIME NË PLANIFIKIM TERRITORI, PROJEKTIM, MBIKËQYRJE DHE KOLAUDIM**”seksioni IV neni 44 ,çdo oferte ekonomike qe rezulton jashte kufirit minimal dhe maksimal të vlerës do të skualifikohet.

2.3.6. Certifikat ISO:

- a) **ISO 9001-2015 – Standard per Sistemin e Menaxhimit te Cilesise (e vlefshme)**, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO).
- b) **ISO 14001 - 2015 - Standard per Sistemin e Menaxhimit te Mjedisit (e vlefshme)**, Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO).

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**



---

**Shtojca 9.**

*(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)*

**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik  
\_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----

Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

## B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të

LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

## Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

### A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]]
etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga	

<p>gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p>	
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ëeb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ëeb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
